



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 78, Datë 19/03/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 164, datë 20.12.2017, e Z. E. N., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “racës” dhe “bindjes politike”, nga ana e Z. B.K., Kryeredaktor i Radio Gjirokastrës.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesi ka filluar punë si nxënës operator teknik pranë Radios së Gjirokastrës, ku ka punuar deri në vitin 1964. Z. E. N. shprehet se duke parë se shumë prej shokëve të tij bënin kronika të ndryshme, edhe ai kishte dashur të bënte një kronikë për historikun e Radios së Gjirokastrës, meqënëse ishte punonjës i vjetër në atë institucion. Ankuesi pretendon se Drejtoresha e Radios ka rënë dakord, që ai ta bëjë kronikën në fjalë, por Kryeredaktori B. K., duke përdorur justifikime të ndryshme e shtynte në kohë një gjë të tillë. Për këtë arsye, Z. E. N. pretendon se diskriminohet nga Z. Blerim Kore për shkak të “bindjes politike” dhe “racës”. Ankuesi kërkon nga Komisioneri marrjen e masave ndaj

Z. Kore, pasi gjykon që nuk ka arsye që ai të mos e bëjë kronikën në fjalë, aq më tepër kur edhe Drejtoresha e Radios ka rënë dakord për një gjë të tillë.

Për sa më sipër, meqënëse Komisioneri gjykoi se ankesa në fjalë duhej plotësuar me informacion dhe dokumentacion shtesë, iu drejtua me e-mail specialistes së Zyrës Rajonale Gjirokastër, ku i kërkoi që të lidhej me ankuesin, për të plotësuar ankesën e tij me informacion dhe dokumentacion shtesë, si më poshtë:

1. Adresa dhe numri i celularit të ankuesit, te cilat ishin lënë të paplotësuara në formularin e ankesës;
2. Kopje e librezës së punës së ankuesit;
3. Kopje e aktit të emërimit/kontrata e punës, në detyrën që ankuesi aktualisht mban pranë Radios së Gjirokastrës;
4. Shkresa zyrtare/Akte administrative që provojnë pretendimet e tij;
5. Kartë anëtarësie e ankuesit në njërën prej partive politike ose çdo lloj dokumentacioni tjetër që provon bindjet e tij politike;
6. Informacion mbi racën e ankuesit, vërtetuar nëpërmjet një vërtetimi nga shoqatat përkatëse.

Përgjigja e kthyer me e-mailin e datës 04.01.2018, nga specialistja e kësaj zyre, e informonte Komisionerin, se Z. E. N. refuzonte të jepte informacionin e kërkuar nga Komisioneri dhe i vetmi plotësim i bërë prej tij ishte dhënia e adresës së banimit.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 164, datë 20.12.2017, e Z. E. N., Komisioneri konstatoi :

Në nenin 33, pika 4, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹, parashikohen rastet e mospranimit të ankesave pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për sa më sipër, mbështetur në nenin 33, pika 4, gërma ç), të këtij ligji, Komisioneri gjykon se ankesa nr. 164, datë 10.12.2017, e Z. E. N. nuk pranohet pasi është haptazi e pabazuar dhe e pambështetur në fakte dhe prova konkrete.

¹Neni 33, pika 4, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon: “ Ankesa nuk pranohet nëse:a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 3, gërma ç) të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranim të ankesës nr. 164, datë 10.12.2017, e Z. E. N., pasi është haptazi e pabazuar dhe e pambështetur në fakte dhe prova konkrete.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha – punesim
Shkak – raca, bindja politike